

Përkthim pjesor i Statutit të FEPA-s

Kapitulli III

Kuota e anëtarësisë

- 10.1 Të gjithë anëtarët duhet të paguajnë një kuotë vjetore. Vlera e kuotës do të përcaktohet nga Kongresi i FEPA-s.
- 10.2 Kuota e anëtarësisë duhet të paguhet deri më 30 Prill të vitit kalendarik.
- 10.3 Çdo anëtar që nuk paguan kuotën vjetore nuk do të ketë të drejtë vote në Kongresin pasues.
- 10.4. Çdo anëtar që nuk paguan kuotën për një periudhë 2 vitesh kalendarikë, anëtarësinë do ta ketë të pezulluar. Nëse mospagimi është më i gjatë se 2 vjet, anëtarësia do të jetë e anuluar.
- 10.5 Riaktivizimi i anëtarësisë do të pranohet nëse do të paguhet të gjitha detyrimet e prapambetura.

Kapitulli IV – Organizimi dhe Administrimi

Kongresi

12.6 Përfaqësimi në Kongres

12.6.1 Çdo anëtar i FEPA-s ka një votë.

12.6.4 Anëtarët mund të përfaqësohen në Kongres me ndërmjetësi. Ajo duhet të jetë në favor të një federate tjetër anëtare.

12.6.5 Një anëtar mund tja delegojë votën vetëm një Federate tjetër anëtare.

Mocione(Propozime)

13.1 Propozimet mund të bëhen nga Bordi i FEPA-s dhe Federatat anëtare.

13.2 Propozimet duhet të paraqiten tek Bordi i FEPA-s me shkrim të paktën tre muaj përpara Kongresit. Këto duhet t'ju dërgohen të gjithë anëtarëve.

13.3 Propozimet mund të dërgohen nga Bordi i FEPA-s deri në 2 muaj përpara Kongresit. Propozimet duhet të qarkullojnë tek të gjithë anëtarët.

13.4 Propozimet e paraqitura gjatë drejtimit të Kongresit mund të pranohen për diskutim, nëse shumica e anëtarëve janë të pranishëm dhe Bordi i FEPA-s bie dakord.

Votimi

16.1 Kuorumi i nevojshëm që Kongresi të marrë vendim duhet të jetë prezenca fizikisht ose me përfaqësi e më shumë se gjysmës së anëtarëve në apelin e parë.

16.2 Nëse nuk plotësohet kuorumi, Kongresi i FEPA-s do të thirret edhe një herë nga Bordi 30 minuta pas apelit të parë. Ky Kongres i përsëritur e ka kuorumin me çdo numër anëtarësh të pranishëm.

16.3 Në rast barazimi votimi do të përsëritet.

16.4 Votat me shkrim, të anëtarëve jo të pranishëm apo të paraqitura me ndërmjetësi nuk pranohen në mbledhje të Kongresit.

BORDI I FEPAS

17.3 Të gjithë anëtarët e Bordit do të zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare.

17.4 Presidenti do të shërbejë jo më shumë se 2 mandate të plota. Të gjithë anëtarët e tjerë mund të shërbejnë deri në 3 mandate të plota.

17.5 Presidenti do t'i shpërndajë detyrat anëtarëve të Bordit në mbledhjen e parë pas zgjedhjes.

17.8 Detyrat administrative do të kryhen nga Sekretari i Përgjithshëm.

17.9 Sekretariati do të jetë në vendin e Sekretarit të Përgjithshëm. Ai do të punojë në baza vullnetare pa kosto për FEPË-n.

17.11 Në mungesë të Presidentit, Zevendës Presidenti ose arkëtari do të veprojnë si Kryetar.

Kapitulli V – Menaxhimi financiar

18.1 Bordi do të administrojë financat e FEPA-s. Anëtari i Bordit përgjegjës për këtë detyrë është Arkëtari.

18.2 Arkëtari do të mbajë të gjitha fondet dhe do të mbledhë dhe paguajë në emër të FEPA-s. Ai do të mbajë llogarinë e të gjitha transaksioneve financiare.

18.3 Arkëtari do të mbyllë llogaritë deri në 31 dhjetor të çdo viti dhe t'ja paraqesë Bordit deri më 31 Mars të vitit pasardhës. Llogaritë e aprovuara nga Bordi do t'i paraqiten Kongresit për aprovim.

18.4 Llogarite duhet të auditohen në kohën e duhur përpara Kongresit.

18.5 Çdo veprim financiar i FEPA-s do të kryhet vetëm pas konfirmimit të Arkëtarit.

18.6 Çdo shpenzim që kalon limitin e aprovuar nga Bordi do të kërkojë nënshkrimin e Presidentit përveç asaj të Arkëtarit.

Chapter IX – Klauzola të Përgjithshme.

Language

25.1 Gjuha zyrtare e FEPA-s është anglishtja.

25.2 Punimet e Kongresit do të përcillen në anglisht. Me kërkesë dhe vendimin e shumicës së delegatëve, përkthimet do të paraqiten në frëngjisht, gjermanisht ose spanjisht.

Aprovimi i Statutit

29.1 Ky statut u aprovua në Kongresin e FEPA-s më 1 Shtator 2002 në Amsterdam dhe u ndryshua në Kongresin e FEPA-s më 5 Tetor 2013 në Madrid. Ndryshimet kanë hyrë në fuqi menjëherë pas këtij Kongresi. Në të njëjtën ditë shfuqizohen të gjitha statutet e mëparëshme.

Shënimi im: Ky statut gjendet në Websiti-n e FEPA-s i cili është rinovuar përpara rreth 2 muajve.

Përkthimi: Edmond Budo